

VENDIM
Nr. 138, datë 20.3.2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, GJYKATËN E LARTË, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

- a) Në fund të pikës 1/3/a shtohet emërtesa "Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar";
- b) Në shkronjën "b", të pikës 1/3:
 - i) emërtesat "Instituti i Zhvillimit të Arsimit" dhe "Inspektorati Shtetëror i Arsimit" shfuqizohen;
 - ii) shtohet emërtesa "Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar".
- c) Pas pikës 9/13 të shtohet pika 9/14, si më poshtë vijon:

"9/14. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Titullar i institucionit" në Drejtorinë Qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar janë sipas lidhjes nr. 6/14, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij."

- ç) Pika 12/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"12/1. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Titullar institucioni" në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar janë sipas lidhjes nr. 9/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij."

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2019, të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion dhe të fillojnë nga momenti i transferimit apo emërimit të nëpunësve në pozicionet e reja, pas miratimit të strukturave dhe organikave përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe

Lidhja nr. 6/14

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Titullar institucioni" në Drejtorinë Qendrore të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, si dhe shtesa e kualifikimit

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË	SHTESA E KUALIFIKIMIT

		PUNËS PAGA E GRUPIT	
Titullar i institucionit	II-a	1	Shkalla e tretë (“Mësues i kualifikuar”) - 30% Shkalla e dytë (“Mësues specialist”) - 40% Shkalla e parë (“Mësues mjeshtër”) - 50%
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes	III-a/1	1	Shkalla e tretë (“Mësues i kualifikuar”) - 30% Shkalla e dytë (“Mësues specialist”) - 40% Shkalla e parë (“Mësues mjeshtër”) - 50%
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës	III-a/1	1	0
Specialist në sektorët e përmbajtjes	IV-a	1 ose 2 ose 3	Shkalla e tretë (“Mësues i kualifikuar”) - 30% Shkalla e dytë (“Mësues specialist”) - 40% Shkalla e parë (“Mësues mjeshtër”) - 50%
Specialist në sektorët mbështetës	IV-a	1 ose 2 ose 3	0
	IV-b		

Shtesa për kualifikim jepet sipas dëshmisë së kualifikimit individual dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

Lidhja nr. 9/1

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar, si dhe shtesa e kualifikimit

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHTESA E KUALIFIKIMIT
Drejtor i drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar	III-b	1	Shkalla e tretë (“Mësues i kualifikuar”) - 30% Shkalla e dytë (“Mësues specialist”) - 40% Shkalla e parë (“Mësues mjeshtër”) - 50%
Drejtor i zyrave vendore të arsimit parauniversitar; përgjegjës sektori në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar	IV-a	1	Shkalla e tretë (“Mësues i kualifikuar”) - 30% Shkalla e dytë (“Mësues specialist”) - 40% Shkalla e parë (“Mësues mjeshtër”) - 50%

Përgjegjës sektori në zyrat vendore të arsimit parauniversitar	IV-b	1	Shkalla e tretë (“Mësues i kualifikuar”) - 30% Shkalla e dytë (“Mësues specialist”) - 40% Shkalla e parë (“Mësues mjeshtër”) - 50%
Specialist në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar	IV-b	1 ose 2 ose 3	Shkalla e tretë (“Mësues i kualifikuar”) - 30% Shkalla e dytë (“Mësues specialist”) - 40% Shkalla e parë (“Mësues mjeshtër”) - 50%
Specialist në zyrat vendore të arsimit parauniversitar	IV-c	1 ose 2 ose 3	Shkalla e tretë (“Mësues i kualifikuar”) - 30% Shkalla e dytë (“Mësues specialist”) - 40% Shkalla e parë (“Mësues mjeshtër”) - 50%

Shtesa për kualifikim jepet sipas dëshmisë së kualifikimit individual dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

